Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE , Rruga BULEVARDI ZOGU I PARE , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00005906 , Datë: 29/08/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: BODRUMI NE SHKALLEN E DYTE 4551

DREJTORI
Kiara Haskaj

Data e lëshimit 29/08/2023

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

VENDIM
Nr. 526, datë 7.9.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1163, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË SEKRETARIATIT TË *'BOLOGNA FOLLOW UP GROUP'* NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1163, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Qëllimi parësor i punës së nënkryetarit të "*Bologna Follow Up Group*" dhe sekretariatit të "*Bologna Follow Up Group*" (në vijim "BFUG") është kryerja të gjitha funksioneve dhe detyrimeve që u lindin në zbatim të rregullave dhe procedurave të funksionimit të BFUG-së. Detyrat e tyre ushtrohen sipas kohëzgjatjes, si më poshtë vijon:

a) Nënkryetari i BFUG-së, kryetari dhe nënkryetari i sekretariatit të BFUG-së deri në realizimin e detyrimeve sa i takon kalimit të detyrës nënkryetarit dhe sekretariatit të ardhshëm të BFUG-së dhe përfaqësimit në takimet vijuese si nënkryetar i BFUG-së dhe kryetar/nënkryetar i sekretariatit të BFUG-së dalës, deri më 31 dhjetor 2024;

b) Punonjësit e sekretariatit të BFUG-së deri më 31 korrik 2024, me përmbushjen e detyrimeve për kalimin e detyrës sekretariatit të ardhshëm të BFUG-së.

Nënkryetari i BFUG-së asistohet nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, për të mbështetur aktivitetet e tij dhe për koordinimin e veprimtarive që do të organizohen deri në përfundim të periudhës së mbajtjes së këtij pozicioni nga Republika e Shqipërisë, si dhe koordinimin e punës për organizimin e Konferencës Ministrore dhe Dialogut të Politikave Globale në maj 2024. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit, sipas kërkesës së nënkryetarit të BFUG-së dhe mbi bazën e propozimit të përcjellë nga ministri përgjegjës për arsimin.".

b) Pika 5 shfuqizohet.

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Sekretariati drejtohet nga kryetari dhe përbëhet nga personel i punësuar me kohë të plotë, ekspertë dhe personel i punësuar me kohë të pjesshme, si më poshtë vijon:

a) Një ekspert i nivelit të lartë në pozicionin e kryetarit të sekretariatit të BFUG-së, i angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e sekretariatit;

b) Një ekspert i nivelit të lartë në pozicionin e nënkryetarit të sekretariatit të BFUG-së, i angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme, i cili asiston kryetarin e sekretariatit në kryerjen e detyrave të tij;

c) Ekspertë të nivelit të lartë, të angazhuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në pozicionin e anëtarëve të sekretariatit të BFUG-së, për një angazhim mujor në total të të gjithë ekspertëve që punësohen, deri në 968 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) orë pune/muaj;

ç) Ekspertë të angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme në pozicionin e anëtarit të sekretariatit të BFUG-së për një angazhim mujor në total të të gjithë ekspertëve që punësohen, deri në 1 144 (një mijë e njëqind e dyzet e katër) orë pune/muaj.

Personeli i sekretariatit duhet të ketë njohuri shumë të mira në fushën e arsimit të lartë dhe të procesit të Bolonjës.

Struktura e sekretariatit, pozicionet me kohë të plotë apo të pjesshme, si dhe detyrimet kontraktuale të personelit të sekretariatit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin mbi bazën e propozimit të kryetarit të sekretariatit të BFUG-së. Personeli i sekretariatit emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, nëpërmjet thirrjeve për shprehje interesi.".

ç) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Niveli i shpërblimit për punën e kryer nga nënkryetari i BFUG-së, personeli i sekretariatit të BFUG-së, personeli i ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të tjera shtetërore, që ofrojnë mbështetje jashtë kohës normale të punës dhe anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar sipas këtij vendimi, është, si më poshtë vijon:

a) Për nënkryetarin e BFUG-së dhe punonjësit e sekretariatit të BFUG-së, shpërblimi t'u referohet nivelit të pagave të personelit në institucionet publike të arsimit të lartë, të përcaktuara me vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, si më poshtë vijon:

i. Nënkryetari i BFUG-së, kryetari dhe nënkryetari i sekretariatit sa paga e personelit akademik "Rektor";

ii. Ekspertët e nivelit të lartë dhe/ose të huaj/nga diaspora shqiptare, të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, referuar pagës së personelit akademik të kategorisë "Profesor";

iii. Ekspertët e punësuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, referuar pagës së personelit akademik që zotëron gradën shkencore "Doktor".

b) Stafi i ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të tjera shtetërore, i cili ofron mbështetje, jashtë kohës normale të punës, në realizimin e detyrimeve të sekretariatit shqiptar të BFUG-së sa u takon çështjeve financiare, ligjore apo menaxhimit të grandit të BE-së për sekretariatin e BFUG-së, praktikave që lidhen me realizimin e udhëtimeve të personelit të sekretariatit, në kuadër të realizimit të detyrimeve të tyre respektive, mirëmenaxhimin e faqes *web www.ehea.info* apo shërbime të tjera që do të kryhen në funksion të veprimtarisë së sekretariatit, sipas kërkesave që do të përcillen nga kryetari/nënkryetari, do të konsiderohet si ekspert me kohë të pjesshme, brenda totalit të orëve të përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 7, të këtij vendimi;

c) anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, shpërblehen në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.".

d) Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"12/1. Ngarkohen nënkryetari i BFUG-së, sekretariati, grupi i punës që asiston atë dhe ministria përgjegjëse për arsimin të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar organizimin e Konferencës Ministrore dhe dialogut të politikave globale në maj 2024 dhe të gjitha aktiviteteve që do të parashikohen deri në zhvillimin e tyre, si dhe të bashkëpunojnë për organizimin e programeve kulturore dhe promovuese në kuadër të këtyre aktiviteteve me ministritë përgjegjëse për turizmin dhe kulturën.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 527, datë 7.9.2023

PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË KOSTOS SË STUDIMEVE PËR PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MJEKËSI E PËRGJITHSHME" NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE ÇDO MBËSHTETJE TJETËR PËR STUDENTËT E KËTIJ PROGRAMI STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 60/2023, "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kostoja e studimeve në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit

të lartë (IAL), të cilat ofrojnë këtë program studimi, si dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi, të llogaritet sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë vendim.

2. Institucioni i arsimit të lartë publik, në përllogaritjen e kostos së studimit të programit "Mjekësi e përgjithshme", merr në konsideratë kostot direkte dhe ato indirekte, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

a) Kostot direkte përfaqësohen nga të gjitha shpenzimet, që parashikohen të kryhen në një vit buxhetor për ofrimin e shërbimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor e që lidhen drejtpërsëdrejti me treguesit, si më poshtë vijon:

i. Numrin e kuotave të certifikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, në vitin përkatës akademik të studimeve;

ii. Numrin e studentëve për një grup mësimor, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;

iii. Numrin e personelit akademik, të personelit ndihmësakademik, të personelit administrativ e të punonjësve të shërbimeve mbështetëse të miratuar me vendim të organeve kolegjiale të IAL-së;

iv. Shpenzimet (bruto) për personelin: paga, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që paguan punëdhënësi për personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ e atë të shërbimeve mbështetëse, si dhe shpërblime apo ndihma financiare, që përballohen nga fondi i veçantë, sipas kuadrit ligjor në fuqi;

v. Shpenzimet për bursa dhe trajtime të tjera për studentët.

b) Kostot indirekte përfshijnë shpenzimet kapitale dhe shpenzime të tjera operative, që parashikohen të kryhen nga institucioni i arsimit të lartë, si më poshtë vijon:

i. Shpenzime kapitale për ndërtime dhe rehabilitime të godinave, krijimin e infrastrukturës kapitale për realizimin e procesit të mësimdhënies e të mësimnxënies, përfshirë edhe infrastrukturën mësimore-didaktike dhe atë të kërkimit shkencor;

ii. Shpenzime operative për sigurimin e jetës së studentëve në shoqëritë e sigurimit, sigurimin e infrastrukturës fizike (godinave) dhe të bazës laboratorike e mësimore-didaktike, shpenzime për energjinë elektrike, ujin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve;

iii. Shpenzime për kancelari, karburant për ngrohje dhe mjete transporti, shpenzime për shërbime bankare, shpenzime për qira, pritje-përcjellje, si dhe shpenzime të tjera të institucionit të arsimit të lartë, të papërfshira më lart e që janë në funksion të shërbimit të mësimdhënies e të mësimnxënies dhe të kërkimit shkencor.

3. Ndarja e kostove direkte dhe indirekte, por pa u kufizuar në to, parashikohet në raportet e mëposhtme:

a) Pjesa e shpenzimeve të personelit parashikohet në masën 75%-80% të shpenzimeve/kostos totale të studimeve;

b) Pjesa e shpenzimeve kapitale parashikohet në masën 10%-15% të shpenzimeve të personelit;

c) Pjesa e shpenzimeve operative parashikohet në masën 15%-20% të shpenzimeve të personelit.

4. Institucioni i arsimit të lartë publik, i cili ofron program studimi të integruar të ciklit të dytë në "Mjekësi e përgjithshme", bazuar në metodologjinë e parashikuar më sipër, përllogarit, çdo vit, në mënyrë të detajuar, koston e plotë për këtë program studimi.

5. Shuma totale e shpenzimeve të përllogaritura për një vit buxhetor përpjesëtohet me numrin e studentëve, që ndjekin programin e studimit, për të vlerësuar koston për student.

6. Kostoja e përllogaritur dhe e miratuar nga organet kolegjiale të IAL-së bëhet publike për studentët përpara fillimit të vitit akademik.

7. Studenti, që ndjek programin e studimit të integruar të ciklit të dytë në "Mjekësi e përgjithshme" dhe plotëson kushtet sipas ligjit nr. 60/2023, "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë", ka të drejtën për çdo mbështetje tjetër, që nuk përfshihet në kostot e studimeve.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 529, datë 7.9.2023

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE/TRUALL", PËR SIPËRFAQEN 312 m², PJESË E PASURISË ME NR. 1, ZONA KADASTRALE 2264, BASHKIA FINIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane/truall", për sipërfaqen 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², pjesë e pasurisë me nr. 1, zona kadastrale 2264, Bashkia Finiq, për ndërtimin e strukturës "Kapanon për magazinimin e prodhimit në funksion të pemëtores", sipas kartelës së pasurisë, lidhjes nr. 1 dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në Këshillin e Qarkut Vlorë pasqyron në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane/truall", për sipërfaqen ndërtimore të pasurisë me nr. 1, zona kadastrale 2264, Bashkia Finiq, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në Këshillin e Qarkut Vlorë, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2264006231
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2264 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 1 , Sipërfaqja Totale 95812 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale J-34-5-(83-A , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia Finiq , Rruga krane , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPERISE , Nr. Identifikimi/NIPT SG1729058141 , Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia - , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00000377 , Datë: 08/11/2019

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00000377	08/11/2019		NE BAZE TE VKM 45 DT29.01.2014 KJO PASURI KALON NE ADMINISTRIM TE MINISTRISE SE BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL			0		
00000389	18/05/2020	Qera për pasuritë bujqësore, me afat mbi nëntë vjet	Kontratë qeraje për pasuritë bujqësore, me afat mbi nëntë vjet	Nr.12 30 Rep Nr.20 6 Kol	01/04/2020	99 vite	Terra - nova	L94106803S

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi:

DREJTORI
Aida Demi

Albjona Rexho — Digitally signed by: Albjona Rexho Date: 2023.08.31 07:13:22 +02'00'

Aida Demi — Digitally signed by: Aida Demi Date: 2023.08.31 08:19:40 +02'00'

Data e lëshimit 31/08/2023

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Sarandë
Date:2023/08/31 19:12:39 +02'00'
J62027011I20230831191232 95ASHK_

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

LIDHJA Nr. 1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m²	Sipërfaqja ndërtimore m²	Emërtimi i strukturës
1	Vlorë	Finiq	2264	Krane	1	95 812	312	Ndërtim kapanoni për magazinimin e prodhimit në funksion të pemëtores.

PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT

LEJE NDERTIMI PER OBJEKTIN "NDERTIM KAPANONI PER MAGAZINIM E PRODHIMIT NE FUNKSION TE PEMTORES"
ZONA Z INDUSTRIALE RR NACIONALE SARANDE-GJIROKASTER KM7 FINIQ KRANE Z K 2264 J 34-5(83 A)
QIRAMARES "Terra Nova" shpk Pasuria Nr 1 Vol 6 FQ 231
INVESTITOR "TERRA NOVA" sh p b
MIRATOHET BASHKIA FINIQ VENDIMI NR DATE / /

RR.NA SARANDE-GJI
URE BETONI
RRUGE DYTESORE
ENTRANCE
KAPANON
Vija e Sip Tokes qe Zhvillohet
SHKALLA 1 250

TREGUESIT E ZHVILLIMIT
SIPERFAQJA E TOKES SIPAS KONTRATES 95812 M2
SIPERFAQJA E TOKE QE DO TE ZHVILLOHET PER 4100M2
SIPERFAQJA MAKSIMALE E TOKES QE ZIHET NGA
STRUKTURA NDERTIMORE SIP OBJEKTIT LARTESI 1934 M2
SIPERFAQJA RRUGE SHERBIMI DYTESORE 685 M2
SIPERFAQJA PARKIMI PER NJESIN E SHERBIMIT 1286 M2
SIPERFAQJA E GJELBERUAR 195 M2

SIPERFAQE E ZENE NGA STRUKTURA 312 M2
NR I KATEVE NDERTIMI 1 KATE
INTENSITETI I NDERTIMIT I=0,042 %
LARTESIA NE METRA E STRUKTURES 6.20 m
KSHT 0.02M3/M2
DISTANCAT MINIMALE NGA KUFIRI I PRONES

MIRATOHET
KRYETAR
KRISTO KIÇO

ORTOFOTO E ZONES SE ZHVILLIMIT SHKALLA 1:2500

POZICIONI KADASTRAL Z K Nr 2264 Nr pas 1 SHKALLA 1:5000

VENDODHJA E OBJEKTI

KORDINATAT E PARCELES ZHVELLMORE

	X	Y
1	420088.7432	416078.5026
2	420101.0223	416060.9578
3	420097.6688	416045.4116
4	420104.7746	416035.8660
5	420070.3344	416009.6122
6	420039.2510	416048.9693

PLANVENDOSJE LEJE ZHVILLIMI

Titulli Projektit "NDERTIM KAPANONI PER MAGAZINIME PRODHIMIT, NE FUNKSION TE PEMTORES"

Investitori BASHKIA FINIQ

Shkalla 1:100

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Territorit/ Bashkia Finiq/ Ing. Vasil Loki

Grupi projektimit: Arch. Edmond Rustemi; Ing. Elmet Sinaxhi Arch.; Ing. Mirela Asqeri Bajrami; Dorin Baso

Nr. Licences: A 12791; HT 01712

Data: Shtator 2021

Drejtoria / Fazat: Projekt Idea

Kontrolloret Urbane

Titulli: Harta Integrime

FINIQ

VENDIM
Nr. 531, datë 7.9.2023

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE SHTETËRORE "OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA" SHA, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare, me kapital 100% shtetëror, me emërtimin Operatori i Blerjeve të Përqendruara (në vijim "OBP"), për ofrimin e shërbimeve të prokurimeve për autoritetet/entet kontraktore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Shoqëria aksionare, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për ekonominë.

4. Kapitali fillestar i regjistruar për krijimin e shoqërisë aksionare të jetë 20 000 000 (njëzet milionë) lekë dhe përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Ministria përgjegjëse për ekonominë transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ministria përgjegjëse për ekonominë ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;

b) regjistrimin e shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. OBP sh.a. është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

6. Organet drejtuese të shoqërisë aksionare OBP sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, janë: Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori. Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullohen dhe funksionojnë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe statutit të OBP sh.a.

7. Drejtori i OBP sh.a. emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit. Kriteret për emërimin e drejtuesit të shoqërisë janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo "Master profesional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

d) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion, prej të cilave 3 (tre) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

8. Drejtori i OBP sh.a., lirohet nga detyra, kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;

c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit.

9. Drejtori i OBP sh.a. shkarkohet nga detyra, kur:

a) kryen shkelje të rënda të etikës;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

ç) me vendim gjyqësor të formës së prerë i është kufizuar apo hequr zotësia për të vepruar.

10. Me qëllim realizimin me efektivitet dhe efektshmëri të procedurave të prokurimit, drejtori i OBP sh.a., mund të marrë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.

11. Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si më poshtë vijon:

a) blerje automjetesh;

b) blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët;

c) blerje materialesh kancelarie;

ç) blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim;

d) blerje materialesh të ndryshme për pastrim;

dh) blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

e) blerje këpucësh;

ë) blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;

f) blerje tonerash;

g) shërbime në fushën e sigurimeve, si:

i. sigurim i automjeteve;

ii. sigurim i mjeteve lundruese;

iii. sigurim i mjeteve ajrore;

iv. sigurim jete dhe shëndeti;

v. sigurim i godinave publike;

gj) shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;

h) shërbim pastrimi;

i) shërbim lavanderie;

j) shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;

k) riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;

l) botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;

ll) blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;

m) riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;

n) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;

nj) shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi;

o) blerje artikujsh ushqimorë;

p) blerje pajisjesh kondicionimi;

q) shërbim gjelbërimi;

r) rikonstruksion objektesh.

12. OBP sh.a., me kërkesë të një apo të disa autoriteteve/enteve kontraktore, zhvillon procedura prokurimi edhe për punë/mallra/shërbime, të cilat nuk janë listuar në pikën 11, të këtij vendimi, në rastet kur autoriteti/enti kontraktor kërkues nuk ka kapacitete apo njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.

13. Autoritetet/entet kontraktore duhet t'i dërgojnë OBP sh.a., si organ qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe të dhëna për fondin përkatës për mallrat e shërbimet përkatëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin pasardhës.

14. Mënyra e organizimit dhe komunikimit institucional mes OBP sh.a. dhe autoriteteve kontraktore rregullohet në rregulloren e miratuar nga OBP sh.a., sipas parashikimit të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

15. Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimit, për të nënshkruar marrëveshjen kuadër dhe kryerjen e procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.

16. Shoqëria aksionare financohet nga të ardhurat e veta, të ardhura nga shërbimet ndaj të tretëve, të konsulencës, nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e shoqërisë aksionare përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

17. Shoqëria aksionare mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.

18. OBP sh.a., për nevojat e saj mund të nënshkruajë:

a) marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) marrëveshje bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e ndihmës/ekspertizës së nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi apo rritjen e kapaciteteve institucionale;

c) marrëveshje bashkëpunimi me ekspertë të fushave të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi.

19. Ministria përgjegjëse për ekonominë i siguron shoqërisë aksionare mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

20. Procedurat prokurimit të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik, deri në datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a., do të vijojnë të ndiqen dhe të përmbyllen nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP), por jo më vonë se data 31.12.2023. Procedurat e prokurimit sipas kësaj pike, të papërfunduara nga ASHPP-ja pas datës 31.12.2023, do të vijojnë deri në përfundimin/mbylljen e tyre nga OBP sh.a.-ja. Pas datës 31.12.2023, llogaria e administratorit të ASHPP-së në Sistemin e Prokurimit Elektronik i kalohet OBP sh.a.-së, deri në përfundimin e procedurave të prokurimit në proces.

21. Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. njofton me shkrim institucionet e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë. Procedurat e prokurimit, që nuk janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, deri në momentin e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a., nuk i adresohen ASHPP-së.

22. Me mbylljen e veprimtarisë së ASHPP-së brenda 30 (tridhjetë) ditëve, inventari ekonomik, dokumentar dhe arkivi elektronik në Sistemin e Prokurimit Elektronik transferohet pranë OBP sh.a.-së. Për punonjësit aktualë të Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara, në rastin e mbylljes së institucionit, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

23. Me mbylljen e ushtrimit të veprimtarisë të ASHPP-së sipas këtij vendimi, vendimi nr. 393, datë 9.6.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara dhe ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë", shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 133
Datë: 2023/09/12 14:01:44
38039e09-5039-4497-a93d-ada1062326eb

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë